



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, neneve 17, 38, 60 dhe 61 të Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, mori këtë,

VENDIM PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KOD TË RI

Neni 1

Me këtë vendim miratohet shtimi i buxhetit dhe krijimi i kodit të ri buxhetor për projektin "Furnizimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor në Komunën e Podujevës" në vlerë 5,925.00€, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 2

Projekti mund të krijohet nga mjetet e participimit të qytetarëve bazuar në Marrëveshjet e Mirëkuptimit në mes Komunës, përfituesve të subvencionit dhe Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA)

Neni 3

Në bazë të marrëveshjes Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) do ta financoj projektin me 55% apo 21,725.00€ të vlerës së projektit, Komuna e Podujevës me 30% apo 11,850.00€ dhe fermerët do të participojnë me 15% apo 5,925.00€.

Neni 4

Projekti sipas nenit 1 të këtij vendimi mbulohet me mjete financiar nga participimi prej 15% të vlerës së përgjithshme nga ana e përfituesve, 30% të vlerës së përgjithshme nga Komuna e Podujevës, 55% Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) dhe i njëjti bënë pjesë në kategorinë subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural - kodi i programit 47005.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021

Nr.Prot.01-320/01-0071615/23
Podujevë, datë; 27 shtator 2023



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha